



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
DREJTORIA E AUTORIZIMEVE

Nr. 1967/Prot.  
11

Tiranë, më 16.09.2019

Lënda: Përgjigje kërkesës tuaj për informacion mbi disa faqe online.

**QENDRËS SHQIPTARE MEDIALOOK**  
Tiranë

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), administron domain-in “.al”, bazuar në pikën k) të nenit 8 të Ligjit Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al””, e ndryshuar.

Bazuar në kërkesën tuaj, datë 27.08.2019 (nr. 1967 prot. i AKEP datë 28.08.2019) me lëndë: “Kërkohej informacion mbi faqe online me prapashtesën .al me përmbajtje pornografie dhe/ose materiale të dëmshme për të mitur gjatë periudhës 2010 - 2019”, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 datë 21.02.2008 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Bazuar në nenin 2, pika 1, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku citohet: “Ky ligj nuk zbatohet për përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike”, AKEP nuk ka kompetencë ligjore të shqyrtojë përmbajtjet e komunikimeve elektronike, pra nuk ka kompetencë të shqyrtojë as përmbajtjet e faqeve web të internetit.

Gjatë regjistrimit të domaineve në rast konstatimi emërtimi domaini me .al me karakter abuziv, etj, AKEP vepron në zbatim të nenit 19 të Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008, pika 19.4 ku përcaktohet që emrat e “ndaluar” përfshijnë por pa u kufizuar në to, emra me kuptim abuziv, ofendues, racist, fjalë që lidhen me krime apo sjellje të këqija si dhe ato të cilat janë në kundërshtim me zakonet e mira.

Përgjatë periudhës 2010-2019, AKEP nuk ka konstatuar faqe me domain në zonën “.al” me përmbajtje pornografie ose materiale të dëmshme me të mitur.

Gjithashtu ju informojmë që referuar gjurmës e) të nenit 15 të Ligjit Nr.9918, gjurmës e), pika 1, e nenit 9, si dhe pikës 9 e Aneksit E, të Rregullores së AKEP nr. 47 datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, çdo operator/sipërmarrës që ofron shërbime/rrjete të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, duhet të respektojë rigorozisht detyrimin ligjor për të marrë masat e duhura juridike dhe teknike për kufizimin e transmetimeve të përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme.

Në rast se AKEP merr kërkesë nga institucione të ngarkuara me ligj për shqyrtimin e përmbajtjes së faqeve të internetit të ndërtuara me domain me ".al" apo domain me prapashtesë tjetër, AKEP menjëherë merr masat duke njoftuar ofruesit e shërbimit internet (ISP-të) për ndërprerjen e aksesit për faqet me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme.

*Duke ju falenderuar,*

**KRYETAR**

**Nir Zela**

